

VENDIM
Nr.139, datë 11.2.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË
LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës“, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009“, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen edhe emërtesat “Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave) dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të përcaktohen në përputhje me vendimin për përcaktimin e pagave për punonjësit mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për këto institucione në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha